Afati për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve

1. Palëve të interesuara u jepet koha e arsyeshme për të dërguar pranë organit publik vendimmarrës komentet dhe rekomandimet e tyre: a) brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit paraprak; b) brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik.
2. Për akte veçanërisht komplekse ose të rëndësishme, sipas vendimit të organit publik, afati për dërgimin e komenteve mund të zgjatet deri në 40 ditë pune nga data e njoftimit

Zgjatja dhe përsëritja e fazës së konsultimit

Organi publik mund të zgjasë afatin për dërgimin e komenteve ose mund të ripërsëritë fazën e marrjes së komenteve e të rekomandimeve në rastet kur:

1. a) organi publik nuk është i kënaqur me cilësinë e komenteve të përftuara;
2. b) në komentet dhe rekomandimet e dhëna janë ngritur çështje të reja të rëndësishme që nuk kanë qenë pjesë e konsultimit fillestar